



Ky material informues u përpilua duke përpunuar informacione nga Treguesi i Daljes në Dritë¹ dhe Raporti i Përgjithshëm për Shqipërinë nga ECPAT.²

Ç'ËSHTË TREGUESI I DALJES NË DRITË

Treguesi i Daljes në Dritë, është krijuar nga Njësia e Inteligjencës së gazetës Economist (Economist Intelligence Unit), dhe mat reagimin e shteteve ndaj shfrytëzimit seksual dhe abuzimit të fëmijëve. Të dhënat e publikuara mbi situatën në grupin e parë prej 60 shtetesh tregojnë se qeveritë, sektori privat dhe shoqëria civile duhet të bëjnë më shumë për të mbrojtur fëmijët nga dhuna seksuale, si dhe të përmbushin angazhimet e tyre në kuadër të Pikës 16.2 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

Treguesi është përllogaritur duke analizuar legjislacionin, politikat dhe reagimet e qeverive të shteteve të ndryshme. Përqendrohet mbi çështje që kanë rëndësi kritike në lidhje me shfrytëzimin seksual dhe abuzimin e fëmijëve, duke përfshirë arsimin, shëndetin riprodhues, normat gjinore, mbështetjen për viktimat, zbatimin e ligjit, si dhe rreziqet nga bota e internetit.

Treguesi merr gjithashtu në konsideratë faktorë, si siguria dhe stabiliteti, mbrojtja sociale, si dhe ndikimin që gjinia dhe norma të tjera ushtrojnë mbi ndalimin apo frenimin e dialogut të hapur shoqëror mbi seksin dhe abuzimin seksual. Secilit vend i jepet një notë e përgjithshme, si dhe një sërë vlerësimesh në lidhje me nënkategori, duke përdorur të dhëna nga 34 tregues dhe 132 nëntregues.


ÇFARË JANË TREGUESIT E PËRGJITHSHËM TË NJË VENDI NGA ECPAT?

Treguesit e përgjithshëm të një vendi nga ECPAT paraqesin në mënyrë të plotë të gjithë informacionin ekzistues në dispozicion të publikut, duke ofruar një analizë të hollësishme të bazës ligjore mbi abuzimin seksual të fëmijëve (ASF) në një vend. Ato japin një vlerësim të arritjeve dhe problemeve në zbatimin e ligjeve, masave për të eliminuar ASF, si dhe sugjerojnë masa konkrete që duhet të jenë prioritet në kuadër të luftës në nivel kombëtar kundër abuzimit seksual të fëmijëve.

SHQIPËRIA

49.8

Në vendin e 32 nga 60-të vende që u vlerësuan nga Indeksi i Daljes në Dritë



Shqipëria u rendit në vendin e 32-të ndërmjet 60 vendeve, në kuadër të vlerësimit të **Treguesit të Daljes në Dritë** mbi përgjigjen dhe reagimin e një vendi ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve, duke marrë notën 49.8.³ Kjo e rendit vendin poshtë Xhamajkës (50.0), dhe përpara Mongolisë (47.9).⁴

Nota e Shqipërisë në kuadër të **Treguesit** u ndikua nga një sërë faktorësh: tradita shqetësuese e pranimi nga ana e shoqërisë të disa formave të dhunës ndaj fëmijëve, paragjykimet ndaj fëmijëve të komunitetit rom, normat gjinore kufizuese, mungesën serioze të fondeve për organizatat e shoqërisë civile (OSHC), si dhe mungesa e planeve parandaluese dhe strategjive nga ana e qeverisë.⁵ Sidoqoftë, disa studime kanë evidentuar zhvillime pozitive gjatë viteve të fundit, si përpjekje të efektshme nga ana e OSHC-ve dhe kompanive private në luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet, si dhe shtimin e përpjekjeve për bashkëpunim ndërkombëtar me partnerë të huaj për të parandaluar shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet, dhe shitjen e trafikimit të fëmijëve për motive seksuale.⁶ Po kështu, janë krijuar mekanizma për denoncimin e rasteve të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, nëpërmjet vënies në funksion të një linje telefonike pa pagesë (ALO 116), që mund të përdoret nga publiku i gjerë për të denoncuar raste apo shqetësime në lidhje me abuzimin seksual të fëmijëve.⁷

PËRKUFIZIMI I ABUZIMIT SEKSUAL TË FËMIJËVE

Fëmijët janë viktimat të shfrytëzimit seksual kur marrin pjesë në aktivitete seksuale në këmbim të një shpërblimi që marrin ata, apo palë të treta. Forma të ndryshme të ASF përfshijnë shfrytëzimin e fëmijëve për prostitucion, shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet, shitjen dhe trafikimin e fëmijëve për qëllime seksuale, shfrytëzimin seksual të fëmijëve në kontekstin e udhëtimeve dhe turizmit, si dhe disa forma të martesave në moshë feminare, në moshë shumë të re, apo martesave me detyrim.⁸

Treguesi i Daljes në Dritë arriti në përfundimin se Shqipëria çalon në lidhje me stabilitetin e mjedisit shoqëror, duke marrë notën 50 nga një total prej 100 pikësh në lidhje me treguesin e trazirave sociale.⁹ Po kështu, korrupsioni dhe krimi i organizuar mbeten probleme serioze,¹⁰ ndërkohë që edhe niveli i varfërisë së fëmijëve mbetet i lartë, pasi 29.6 për qind e fëmijëve në Shqipëri rrezikoheshin nga varfëria në vitin 2018.¹¹ Niveli i lartë i varfërisë ka të ngjarë që të sjellë rrezikshmëri më të lartë për shfrytëzimin e fëmijëve.¹² Gjithashtu, Treguesi ka dalë në përfundimin se normat dhe praktikat kufizuese gjinore, pranimi nga ana e shoqërisë të disa formave të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe paragjykimet ndaj fëmijëve të komunitet rom në Shqipëri, krijojnë kushte të favorshme për rritjen e disa formave të shfrytëzimit seksual.

Situata e komunitetit rom

Nuk ka të dhëna të sakta mbi numrin e pjesëtarëve të komunitetit rom në Shqipëri, me përlogaritje ata shkojnë nga 13,000 - 150,000,¹³ por nuk ka dyshime në lidhje me nivelin e tyre të lartë të papunësisë, kushteve të mjerueshme të jetesës,¹⁴ si dhe faktit se vetëm 66 për qind e fëmijëve romë ndjekin arsimin e detyrueshëm.¹⁵ Dihet mirë se këto probleme i ekspozojnë akoma më tepër fëmijët ndaj shfrytëzimit seksual.

Burime të ndryshme deklarojnë se fëmijët Romë në Shqipëri janë shumë të ekspozuar ndaj rrezikut të trafikimit për shfrytëzim seksual, pasi ata përbëjnë një përqindje tepër të lartë të fëmijëve në situatë rruge.^{16,17,18} Po kështu, një tjetër studim ka dalë në përfundimin se, në komunitete të veçuara apo të integruara rome, disa forma të martesave në moshë fëmijore, në moshë shumë të re, apo martesa me detyrim pranohen dhe mbështeten nga një gamë e gjerë traditash dhe zakonesh.¹⁹ Presioni vjen edhe nga komuniteti dhe faretisi përreth vajzave, duke nxitur martesat në moshë të vogël, madje një pjesëmarrës në studimin e përmendur më lart tha se “nëse vajza e fqinjëve martohet, duhet që të gjejnë se s’bën një burrë edhe për vajzën e tyre.”²⁰ Studimi gjithashtu nënvizoi ekzistencën e qëndrimeve konservatore të disa komuniteteve të veçuara rome, që i japin një rëndësi shumë të madhe mbrojtjes së “nderit” të vajzave, duke justifikuar kështu martesat e vajzave në moshë të vogël, megjithëse dihej se martesa në moshë të vogël do t’i shkaktonte dëm fëmijës.²¹

Ekspozimi i fëmijëve ndaj shitjes dhe trafikimit për shfrytëzim seksual

Fëmijët në Shqipëri janë shumë të ekspozuar ndaj shitjes apo trafikimit për shfrytëzim seksual. Jashtë vendit, fëmijët shqiptarë identifikohen shpesh si viktime të trafikimit në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Greqi, Itali, dhe në Britaninë e Madhe. Për shembull, në Itali, 19 fëmijë shqiptarë viktime të trafikimit u morën në mbrojtje nga sistemi i kujdesit për fëmijët, në vitin 2018.²² Këto shifra zyrtare ka të ngjarë që të jenë vetëm maja e ajsbergut të trafikimit të fëmijëve nga Shqipëria në Itali, veçanërisht po të kemi parasysh se për vitin 2019, vendi mbante vendin e parë për numrin e fëmijëve të pashoqëruar nga prindër në Itali,²³ ndërsa sipas përlogaritjeve më të fundit ka 1393 minorenë nga Shqipëria të pashoqëruar nga prindër në këtë shtet.²⁴ Duke qenë se nuk gëzojnë dot mbrojtje ligjore, dhe autoritetet italiane nuk kanë dijeni për praninë e tyre atje, minorenët e pashoqëruar janë shumë të rrezikuar në lidhje me trafikimin për qëllime të shfrytëzimit seksual.²⁵ Ndonëse nuk ka akoma të dhëna zyrtare për numrin e fëmijëve shqiptarë që kanë rënë viktime të trafikimit, ECPAT Shqipëri përlogariti se deri në vitin 2018, më shumë se 5000 fëmijë nga Shqiptarët u bënë viktime të trafikimit ndërkombëtar.²⁶

Raporte të shumta kanë denoncuar bashkëpunimin e vetë familjeve të fëmijëve në trafikimin e këtyre të miturve në Shqipëri.^{27,28} Në një raport të vitit 2018 EUROPOL theksoi faktin se në shumicën e rasteve të trafikimit të vajzave dhe djemve të mitur shqiptarë në vendet e Bashkimit Evropian për shfrytëzim seksual, familjet e viktimave ishin përfshirë në mënyra të ndryshme në këtë proces – nganjëherë duke u përfshirë me dijeni të plotë në trafikim, dhe herë të tjera, duke u mashtruar nga rrjetet e trafikimit të qenieve njerëzore.²⁹

Shqipëria duhet të ndërmarrë fushata ndërgjegjëse mbi avantazhet e martesave në moshë më të mëdha, si dhe për arsimim e edukim më të mirë në komunitetet më të pambrojtura, në lidhje me seksin dhe marrëdhëniet me dëshirë, në mënyrë që ‘mbrojtja e nderit’ të mos konsiderohet më si e nevojshme

Shqipëria duhet të përmirësojë nivelin e ndërgjegjësimit të familjeve mbi rreziqet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe bashkëpunimin e forcave të rendit me vende që njihen si destinacione të fëmijëve shqiptarë të trafikuar për shfrytëzim seksual

Shqipëria ka një bazë të fortë ligjore në lidhje me mbrojtjen kundër disa krimeve, si përdhunimi dhe trafikimi i fëmijëve. Vendi ka ratifikuar të gjitha konventat kryesore ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve, dhe është firmëtare e anëtare e iniciativave të tjera në rang ndërkombëtar dhe rajonal. Gjithashtu, Shqipëria ka miratuar dhe përmirësuar në mënyrë graduale legjislacionin në lidhje me shfrytëzimin seksual të fëmijëve, për të përmbushur angazhimet e saj ndërkombëtare dhe rajonale. Kështu, miratimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur³⁰ dhe Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve,³¹ në vitin 2017, ishin një hap i rëndësishëm përpara drejt sigurimit të një niveli të përshtatshëm mbrojtjeje të fëmijëve nga shfrytëzimi seksual.

Siqoqoftë, ka akoma mangësi në legjislacion. Për shembull, megjithëse mosha ligjore për martesë është 18 vjeç, fëmijët mund të lejohen të martohen për "shkaqe me rëndësi",³² gjë që shpjegon edhe notën 0 që ka marrë Shqipëria nga **Treguesi** në lidhje me kategorinë e përjashtimeve ligjore për martesë.³³ Po kështu, ka edhe boshllëqe të tjera serioze në legjislacion në lidhje me shfrytëzimin seksual të fëmijëve për prostitucion dhe në internet, ashtu si do të shpjegohet edhe më poshtë.

Shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion

Ligji në Shqipëri në lidhje me shfrytëzimin e fëmijëve për prostitucion ka disa mangësi serioze. Ndonëse prostitucioni është i paligjshëm, ligji nuk e ndalon shprehimisht blerjen e shërbimeve seksuale nga fëmijët, apo përfshirjen dhe nxitjen e fëmijëve për prostitucion. Për më tepër, ligji nuk jep një përkufizim për shfrytëzimin e fëmijëve për prostitucion.

Ligji që e cilëson shkelje penale shitjen edhe blerjen e seksit në Shqipëri nuk bën ndonjë dallim midis të rriturve dhe fëmijëve,³⁴ duke i ekspozuar fëmijët e përfshirë në prostitucion ndaj rrezikut që të trajtohen si shkelës ligji. Ndonëse vihet re se prokurorët ndjekin një rregull të pashkruar për të mos i akuzuar të miturit për shitje të akteve seksuale, fëmijët janë teknikisht të pambrojtur nga situata të tilla.³⁵ Në fakt, në vitin 2015, dy fëmijë u paditën nga prokuroria për pjesëmarrje në prostitucion.³⁶ Këto mangësi në legjislacion i japin Shqipërisë notën 0 për treguesin mbi blerjen e favoreve seksuale.³⁷

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve në internet

Instituti i Statistikave në Shqipëri raportoi në Sondazhin mbi Përdorimin e Internetit dhe Teknologjisë së Komunikimit për Familje dhe Individë për periudhën 2018 – 2019, se 82.2 për qind e familjeve shqiptare kishin akses në internet në vitin 2019, dhe 88.9 për qind e familjeve kishin akses në internet nëpërmjet lidhjeve broadband nga rrjete celulare.³⁸ Një sondazh i zhvilluar me 1000 fëmijë në 2019, zbuloi se 10 për qind e të anketuarve kishin patur formë të ndryshme të eksperiencave të padëshiruara seksuale në internet gjatë vitit të mëparshëm.³⁹ Për më tepër, 16 për qind e fëmijëve të intervistuar thanë se ishin takuar në realitet me një person me të cilin kishin rënë më parë në kontakt nëpërmjet internetit, ndërsa 25 për qind e tyre raportuan se kishin kontakte interneti me një person që nuk e kishin takuar kurrë në realitet.⁴⁰

Të dhënat e dala nga ky studim konfirmohen nga analizat e raporteve të mbledhura nga iSIGURT.al, platforma kryesore në Shqipëri për raportimin mbi çështje të sigurisë së fëmijëve në internet, që drejtohet nga ECPAT Shqipëria. Nga një total prej 6129 raportimesh tek i iSIGURT.al gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, 6054 kishin të bënë me faqe, video apo profile që përmbanin materiale të abuzimit seksual me fëmijët.⁴¹

Megjithë përhapjen e gjerë të përdorimit të internetit në vend, dhe të dhënave se fëmijët në Shqipëri mund të jenë të ekspozuar ndaj shfrytëzimit seksual në internet, ka akoma boshllëqe në legjislacionin shqiptar. Sipas ligjit shqiptar, nuk ka një përkufizim të veçantë për 'materiale të abuzimit seksual me fëmijët', ndërsa akte të paligjshme, si joshja e të miturve dhe shantazhi seksual, nuk janë cilësuar si vepra penale. Për më tepër, Shqipëria nuk kërkon nga kompanitë e shërbimit të internetit (ISP) që të bllokojnë, filtrojnë, apo raportojnë vepra apo materiale të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, përveç rastit kur këto kryhen për qëllime komerciale.⁴² Këto boshllëqe në legjislacion janë edhe arsyeja përse **Treguesi** jep notën 25 nga totali prej 100 pikësh për joshjen e të miturve në internet, dhe 0 nga 100 për mbrojtjen në internet.⁴³

Shqipëria duhet të përmirësojë legjislacionin e saj për të ndaluar blerjen e favoreve seksuale nga fëmijët, dhe për të siguruar mbrojtje për fëmijë që trajtohen si shkelës të ligjit pas shfrytëzimit për prostitucion

Shqipëria duhet të miratojë një përkufizim mbi materialet e abuzimit seksual me fëmijët, në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe kriminalizon formë të tjera të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet, si joshja e të miturve dhe shantazhi seksual në internet

Shqipëria nuk ka ndonjë plan veprimi kombëtar të dedikuar posaçërisht kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve, megjithë përpjekjet e vazhdueshme nga organizata të shoqërisë civile.⁴⁴ Sidoqoftë, Strategjia Kombëtare e Drejtësisë për të Mitur 2017-2020 përmban objektivin për të hartuar dhe vënë në jetë "trajtime të posaçme dhe programe rehabilitimi për fëmijët që janë viktimë të torturës, trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës seksuale, dhe dhunës në familje."⁴⁵ Për më tepër, ekzistojnë disa plane pune në nivel kombëtar për sigurinë e fëmijëve në internet dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Sidoqoftë, këto plane dhe masa nuk mbështeten me fonde të mjaftueshme, nuk merren me martesat në moshë të hershme, në moshë të re, apo me detyrim, dhe as me shfrytëzimin e fëmijëve për prostitucion, apo me shfrytëzimin seksual të fëmijëve në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit.

Mungesa e fondeve dhe akteve konkrete në planet e veprimit kombëtar, strategjitë dhe dispozitat ligjore

Ndonëse ekzistojnë strategjitë, planet dhe baza ligjore në lidhje me shfrytëzimin seksual të fëmijëve në Shqipëri, zbatimi i tyre në praktikë është shumë i dobët. Për shembull, Ligji Nr. 18/2017 kërkon që të gjithë punonjësit e mbrojtjes së fëmijës të jenë punonjës socialë të kualifikuar,⁴⁶ ndonëse deri në maj 2019, vetëm 78 nga 223 punonjës të mbrojtjes së fëmijës (35 për qind) i përmbushnin këto kritere.⁴⁷ Po kështu, sipas Ligjit nr. 18/2017, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, që është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijës, dhe zbatimit të politikave për mbrojtjen e fëmijës, u ngarkua me përgjegjësi shtesë, por në vitin 2019, Komisioni Evropian arriti në përfundimin se burimet financiare dhe njerëzore në dispozicion të këtij institucioni 'nuk korrespondojnë me shtimin e përgjegjësiave.'⁴⁸

Po ashtu, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur kërkon që gjykatësit të marrin trajnimin e nevojshëm për të garantuar mbrojtje maksimale për fëmijët.⁴⁹ Sidoqoftë, pavarësisht nga kjo dispozitë, gjykatës dhe prokurorë nuk janë trajnuar akoma për të siguruar mbrojtjen e duhur për të drejtat e viktimave të mitura.⁵⁰ Për më tepër, në vitin 2016, Prokuroria e Përgjithshme ngriti Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave për të këshilluar dhe mbështetur edhe viktimat e dhunës dhe shfrytëzimit seksual.⁵¹ Sidoqoftë, deri në korrik 2020, kjo zyrë nuk kishte siguruar mbështetje për asnjë viktimë të shfrytëzimit seksual të fëmijëve.⁵²

Të gjitha planet e veprimit kombëtar në lidhje me shfrytëzimin seksual të fëmijëve: Strategjia Kombëtare e Drejtësisë për të Mitur 2017-2020, Plani Kombëtar i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2018-2020, dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Sigurinë e Fëmijëve në Internet 2018-2020 përfundojnë në vitin 2020, dhe deri në korrik 2020, nuk kishin nisur akoma procedurat e hartimit të planeve të reja.⁵³

Ndonëse duhet përshëndetur fakti që ekzistojnë plane, strategji dhe dispozita ligjore, në realitet e gjithë barra për të siguruar shërbimet e nevojshme sociale për fëmijët viktimë të shfrytëzimit seksual, si ndihmë ligjore dhe mbështetje psikosociale bie mbi shpatullat e OSHC-ve. Qeveria siguron pak ose aspak ndihmë për OSHC-të për sigurimin e këtyre shërbimeve. Kjo do të thotë se shumë fëmijë nuk kanë dot akses në shërbime që u garantohen me ligj. Plane dhe strategji pa burime financiare dhe mjete pune janë masa që mbeten në letër.⁵⁴ Kjo situatë shpjegon edhe arsyen përse Shqipëria mori një vlerësim të dobët me 20 nga 100 pikë të mundshme në lidhje me aksesin e viktimave në programe mbështetjeje sipas **Treguesit**.⁵⁵

HAPA PËR TË ARDHMEN

Shqipëria duhet të rinovojë planet e veprimit kombëtar që përfundojnë në vitin 2020, dhe të hartojë një plan specifik kombëtar në lidhje me shfrytëzimin seksual të fëmijëve

Qeveria shqiptare duhet të përmbushë detyrimet e saj për të mbështetur me fonde dhe për të siguruar shërbimet e përcaktuara në plane, strategji dhe dispozita ligjore për të luftuar shfrytëzimin seksual të fëmijëve, për shembull, duke kompletuar trajnimin në punë sociale për të gjithë punonjësit e kujdesit të fëmijës

Përpjekjet e OSHC-ve në Shqipëri meritojnë lëvdata. Sidoqoftë, ndonëse OSHC kanë marrëdhënie të mira me qeverinë në fushën e nxitjes për ndërmarrjen e iniciativave ligjore, ato marrin fonde të pamjaftueshme për të siguruar shërbimet që do të respektonin angazhimet e vetë qeverisë ndaj fëmijëve. Kjo shpjegon edhe faktin pse i jepet nota 50 angazhimit të shoqërisë civile në **Tregues**.⁵⁶ Angazhimi i sektorit privat është i kufizuar. Për shembull, nuk është ndërmarrë thujasë asnjë veprim konkret për të luftuar shfrytëzimin seksual në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit. Angazhimi i sektorit të medias në këtë drejtim u vlerësua me notën 0 në kategorinë përkatëse të Treguesit,⁵⁷ pasi nuk ka rregulla apo udhëzime për median dhe gazetarët në lidhje me raportimin e krimeve që lidhen me shfrytëzimin seksual të fëmijëve.⁵⁸

Angazhimi i Shoqërisë Civile

ECPAT Shqipëri ka punuar për të ngritur struktura mbështetëse si Qendra Burimore për Fuqizimin e Fëmijëve dhe të Rinjve, në vitin 2019, që do të informojë, do të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit, do të këshillojë, mbështesë, referojë dhe raportojë mbi raste dhune ndaj fëmijëve dhe të rinjve.⁵⁹ Qendra do të organizojë trajnime dhe asistencë për punonjës të sistemit të mbrojtjes së fëmijës, forcave të zbatimit të ligjit, dhe personelit të sistemit të drejtësisë. Qendra do të zhvillojë gjithashtu edhe programe ndërgjegjësimi për publikun mbi dhunën seksuale kundër fëmijëve.⁶⁰

Gjithashtu, ECPAT Shqipëri bashkëpunon ngushtë me Google⁶¹ dhe Facebook për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë në platformat e tyre në internet (duke përfshirë edhe Instagram dhe Whatsapp).⁶²

Po kështu, OSHC në Shqipëri kanë bashkëpunuar për organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit. Në vitin 2019, një numër organizatash bashkëpunuan për mbajtjen e forumit të pestë kombëtar "Së Bashku për një Internet më të Sigurtë për Fëmijët dhe të Rinjtë në Shqipëri".⁶³ Për vite me radhë, në një ditë të caktuar, janë organizuar fushata ndërgjegjësimi për fëmijët e moshave shkollore mbi mesazhet me natyrë seksuale (sexting), shkëmbimin apo postimin e pamjeve filmike dhe fotografive intime në internet, si dhe mbi rreziqe të tjera në lidhje me shfrytëzimin seksual në internet.⁶⁴

Më 23 korrik 2020, ECPAT Shqipëri shpallën, me mbështetjen e presidentit të Shqipërisë, fushatën kombëtare "#NEJEMI1" (#WEARE1), për t'i bërë ballë të gjitha sfidave në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve dhe mangësive në sistem, duke angazhuar në këto procese qytetarë, prindër, artistë, politikanë, zyrtarë publikë, të rinj, dhe fëmijë.⁶⁵

Mungesa e angazhimit në sektorin e udhëtimeve dhe turizmit

Angazhimi i sektorit të udhëtimeve dhe turizmit në Shqipëri në luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve është i dobët, dhe nuk ka të dhëna në lidhje me shfrytëzimin e fëmijëve në këtë kontekst. Shqipëria u vlerësua me 33 nga 100 pikë të mundshme për kategorinë e **Treguesit** mbi angazhimin e sektorit të udhëtimeve dhe turizmit.⁶⁶ Vendi ka përjetuar një rritje të madhe të numrit të vizitorëve të huaj, me 6,094,889 vizitorë që hynë në vend gjatë vitit 2019, në krahasim me 3,415,550 persona për vitin 2014.⁶⁷ Asnjë kompani shqiptare e udhëtimeve dhe turizmit nuk ka nënshkruar Kodin e Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Udhëtime e Turizëm (Kodi), ndonëse shtatë kompani ndërkombëtare që i shtrijnë aktivitetet e tyre në Shqipëri janë firmëtare dhe anëtare.⁶⁸ Kodi është një iniciativë e ndërmarrë me qëllimin për të rritur ndërgjegjësimin, për t'i dhënë mundësi dhe mbështetje sektorit të turizmit, që të parandalojë dhe reagojë kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve.⁶⁹ Në vitin 2018, kishte 1326 mjedise të regjistruara hotelerie e mikpritjeje (hotele, motele, kampe, dhoma për buajtje, dhe struktura pushimi malor) në Shqipëri,⁷⁰ dhe në vitin 2019 kishte 1259 agjenci udhëtimi, operatorë turistikë, shërbime rezervimi, dhe kompani që ofronin shërbime të tjera të lidhura me turizmin.⁷¹ Duke qenë se asnjë nga këto kompani nuk është bërë anëtare e Kodit, ka shumë vend dhe hapësira për të përmirësuar nivelin e angazhimit të këtij sektori në luftën kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

Shqipëria duhet të sigurojë fonde për OJQ që realizojnë shërbime në mbështetje të viktimave të shfrytëzimit seksual, në përputhje me angazhimet e qeverisë në planin dhe politikat e hartuara prej saj

Qeveria shqiptare duhet të zbatojë një strategji afatgjatë për të angazhuar sektorin privat në parandalimin e të gjitha formave të shfrytëzimit seksual të fëmijëve, dhe duhet t'i kërkojë të gjitha bizneseve që të respektojnë kriteret e Kodit

Kompanitë e medias në Shqipëri duhet të hartojnë rregulla, praktika pune, dhe terminologji etike për raportimin mbi shfrytëzimin seksual të fëmijëve në rregulloret e tyre të punës

1. Njësia e Inteligjencës së gazetës "The Economist". (2019). *Jashtë Hijeve: Të hedhësh dritë mbi përgjigjen ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve*.
2. ECPAT International. (2020). *Treguesit e përgjithshëm të një vendi nga ECPAT, Shqipëria*. Bangkok: ECPAT International.
3. Njësia e Inteligjencës së gazetës "The Economist". *Indeksi Jashtë Hijeve: Të hedhësh dritë mbi përgjigjen ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve*. Shqipëria.
4. Po aty.
5. ECPAT International. (2020). *Treguesit e përgjithshëm të një vendi nga ECPAT, Shqipëria*. Bangkok: ECPAT International.
6. Po aty.
7. Njësia e Inteligjencës së gazetës "The Economist". (2019). *Profili i Vendlindjes: Shqipëria*.
8. Terminologjia dhe përkufizimet që lidhen me temën e shfrytëzimit seksual të fëmijëve të përdorur në këtë fletë informuese janë në përputhje me rekomandimet e Udhëzuesit Terminologjik për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual. Grupi i Punës Ndërinstitucional. (28 janar, 2016). *Udhëzues Terminologjik për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, i miratuar nga Grupi Punues Ndërinstitucional në Luksemburg*. Bangkok: ECPAT International.
9. Njësia e Inteligjencës së gazetës "The Economist". *Indeksi Jashtë Hijeve: Të hedhësh dritë mbi përgjigjen ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve*. Shqipëria.
10. Freedom House. (2019). *Liria në Botë 2019: Shqipëria*.
11. INSTAT. (2019). *Të ardhurat dhe kushtet e jetesës në Shqipëri, 2017-2018*. 3.
12. ECPAT International. (2016). *Fuqia, Mosndëshkimi dhe Anonimiteti*. 43.
13. Mbrojtësit e të Drejtave Civile. (2018). *Muri i Anti-Ciganizmit Romë dhe Egjiptianë në Shqipëri*. 5.
14. Po aty.
15. UNICEF Shqipëri. (2019). *Raporti Vjetor i UNICEF në Shqipëri 2018*. 23.
16. CARITAS Shqipëri. (2019). *Trafikimi i Fëmijëve është Krim*.
17. Departamenti i Punës së SH.B.A. (2019). *Shqipëria*. 2.
18. GRETA. (2016). *Raport mbi zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore nga Shqipëria*. 7.
19. UNICEF Shqipëri. (2018). *Martesa e Fëmijës*. 44.
20. Po aty.
21. Po aty., 45.
22. Save the Children në Itali. (2019). *Skllëvërit e Vegjël të Padukshëm*. 28. (përkthyer nga Italishtja)
23. Ministria Italiane e Punës dhe Politikave Sociale. (2019). *Raporti i të Miturve të Huaj të Pashoqëruar (MHP) në Itali*. 15.
24. Ministria Italiane e Punës dhe Politikave Sociale. (Qershor, 2020). *Raporti Mjor i të Miturve të Huaj të Pashoqëruar (MHP) në Itali*. 2.
25. Rrjeti Evropian për Parandalimin e Krimit. (2020). *Të miturit e Pashoqëruar në Rrezik: Parandalimi i trafikimit të fëmijëve*. 13-14.
26. ECPAT Shqipëri. (2018). *CRCA Shqipëri: Për sa kohë që policia shqiptare nuk po lufton trafikimin e qenieve njerëzore, fëmijët shqiptarë janë gjithmonë në rrezik të shfrytëzimit*.
27. Po aty.
28. EUROPOL. (2018). *Rrjetet kriminale të përfshira në trafikimin dhe shfrytëzimin e viktimave të mitur në Bashkimin Evropian*. 22.
29. Po aty.
30. Republika e Shqipërisë. (2017). *Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*.
31. Republika e Shqipërisë. (2017). *Ligj për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*.
32. Republika e Shqipërisë. (2003). *Kodi i Familjes së Shqipërisë*. Neni 7.
33. Njësia e Inteligjencës "The Economist". (2019). *Indeksi Jashtë Hijeve: Të hedhësh dritë mbi përgjigjen ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve*. Shqipëria.
34. Republika e Shqipërisë. (1995). *Kodi Penal*. Neni 113.
35. ECPAT International. (2020). *Treguesit e përgjithshëm të një vendi nga ECPAT, Shqipëria*. Bangkok: ECPAT International.
36. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. (2017). *Pozicioni i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit të prostitucionit në proceset gjyqësore në Shqipëri*. 2.
37. Njësia e Inteligjencës "The Economist". (2019) *Indeksi Jashtë Hijeve: Të hedhësh dritë mbi përgjigjen ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve*. Shqipëria.
38. INSTAT. (2019). *Sondazh mbi përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në familje dhe nga individët në vitin 2018 - 2019*. 2.
39. UNICEF. (2019). *Një Klimë Larg*. 53.
40. Po aty. 46.
41. ECPAT Shqipëri. (Korrik, 2020). *Komunikimi Personal*.
42. Republika e Shqipërisë. (2019). *Ligji i Tregëtisë Elektronike*. Neni 20.
43. Njësia e Inteligjencës së gazetës "The Economist". (2019). *Indeksi Jashtë Hijeve: Të hedhësh dritë mbi përgjigjen ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve*. Shqipëria.
44. ECPAT Shqipëri. (2019). *Mbrojtja e fëmijëve nga krimet seksuale dhe dhuna kërkon ndryshime urgjente ligjore*.
45. Ministria e Drejtësisë. (2017). *Strategjia Kombëtare e Drejtësisë për të Mitur 2017 - 2020*. 16.
46. Republika e Shqipërisë. (2017). *Ligj nr. 18/2017 për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*. 51.
47. Komisioni Evropian. (2019). *Raporti për Shqipërinë 2019*. 29.
48. Po aty.
49. Republika e Shqipërisë. (2017). *Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*. Neni 25 dhe 26
50. ECPAT Shqipëri. (Korrik, 2020). *Komunikimi Personal*.
51. *Qendra Shqiptare e Rehabilitimit e Traumën dhe të Torturës*. (2019). *Fëmijët brenda sistemit gjyqësor: Monitorimi i sistemit të mbrojtjes juridike të fëmijëve dhe qasja e barabartë në drejtësi në procedurat civile, administrative dhe penale*. 40.
52. ECPAT Shqipëri. (Korrik, 2020). *Komunikimi Personal*.
53. Po aty.
54. Po aty.
55. Njësia e Inteligjencës "The Economist". *Indeksi Jashtë Hijeve: Të hedhësh dritë mbi përgjigjen ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve*. Shqipëria.
56. Po aty.
57. Po aty.
58. Po aty.
59. ECPAT Shqipëri. (2019). *Ngrihet në Shqipëri Qendra Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Adoshentëve nga Dhuna Seksuale*.
60. Po aty.
61. ECPAT Shqipëri. (2020). *CRCA dhe Google do të punojnë së bashku për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve online në Shqipëri*.
62. ECPAT Shqipëri. (Korrik, 2020). *Komunikimi Personal*.
63. iSIGURT.AL. (2020). *Shqipëria fillon Fushatën "Së bashku për Internet më të Sigurt për Fëmijët në Shqipëri"*.
64. iSIGURT.AL. (2018). *Shqipëria bashkohet me Forcat për Sigurinë e Fëmijëve në internet*.
65. Euronews Albania. (23 Korrik 2020). *Lëvizja Kombëtare "#NEJEMI", Presidenti Meta: Hapat Konkretë për të kapur ngacmuesit e fëmijëve*.
66. Njësia e Inteligjencës së gazetës "The Economist". *Indeksi Jashtë Hijeve: Të hedhësh dritë mbi përgjigjen ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve*. Shqipëria.
67. INSTAT. (2020). *Mbërritjet e të huajve në Shqipëri me qëllim udhëtimi, 2014-2019*.
68. Kodi. (n.d.). *Anëtarët e Kodit: Shqipëri*.
69. Kodi. (n.d.). *Rreth*.
70. INSTAT. (2019). *Turizmi në shifra: Shqipëria 2019*.
71. INSTAT. (2020). *Regjistri i Biznesit /2019*. 24.